



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
KRYETARI

**SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË
EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik shpall procedurën e lëvizjes paralele, dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për pozicionin:

1. Specialisti Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimi pranë Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Komisionin e Prokurimit Publik – Kategoria e pagës: III-b

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se një pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimin nga jashtë shërbimit civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
Deri në 26.05.2023	Lëvizja paralele
Deri në 31.05.2023	Pranim në shërbimin civil

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Të krijojë fusha bashkëpunimi me organe dhe organizma të tjerë joqeveritare për mbështetjen programeve të kualifikimit dhe të veprimtarisë së KPP-së.
2. Ndjek dhe zbaton detyrat për organizimin e aktiviteteve të KPP-në, duke bashkëpunuar me autoritete të tjera analoge, organizmat ndërkombetare brenda dhe jashtë vendit.
3. Merr masat e duhura për pritjen, sistemimin dhe përcjelljen e delegacioneve, apo eksperteve të huaj, që vijnë me ftesë apo në kuadrin e bashkëpunimit me KPP-në.
4. Të zbatojë detyrat që rrjedhin nga kuadri ligjor sektorial, si edhe nga udhëzimet e caktuara nga Përgjegjesi i Sektorit.
5. Të hartojë shkresa, dokumenta, informacione që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme të sektorit dhe prezantimin e tyre tek Përgjegjesi i Sektorit.
6. Merr pjesë në komisione apo grupe pune të ngrituara me urdhër të titullarëve.
7. Përgatit dhe administron dosjen personale si dhe kontratën e punësimit të çdo punonjësi në përputhje me legjislacionin në fuqi duke siguruar ruajtjen e të dhënave konfidenciale.
8. Është përgjegjës për ndjekjen e procedurave të rekrutimit/lirimit për punonjësit, përfshirë publikimi, administrimi i dokumentacionit.
9. Të rekomandojë ndryshime të përshtatshme për rregulloren e brendshme.
10. Të monitorojë list prezencën dhe ditët e punës së stafit.
11. Të ndjekë dhe të zhvillojë procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve.
12. Të kryejë detyra të tjera lidhur me punën.
13. Është përgjegjës për kryerjen e detyrave të tjera sipas legjislacionit në fuqi.
14. Përgatit njoftime me karakter informues në bashkëpunim me njësitë e tjera të institucionit mbi veprimtari të ndryshme dhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit.
15. Menaxhon adresën zyrtare të postës elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik dhe përgjigjet për të, kthen përgjigje në varësi të problematikës dhe pas konsultimeve me eprorët si dhe menaxhon adresat e rrjeteve sociale të KPP-së.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon (kategoria III-b);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master i Shkencave në Shkenca Juridike/ Ekonomike/Shoqërore. Diploma Bachelor të jetë e së njëjtës fushë.

Përvoja:

- Të ketë 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.

Tjetër:

- a- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- b- aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën; aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- c- njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinale (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;
- 3) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 5) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 6) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 7) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 8) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 9) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil;
- 11) Vërtetimin ku specifikohet kategoria e pagës në pozicionin aktual që ushtron kandidati;

12) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;

13) formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas lidhjes <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-ivetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-oseushtrojne-funksione-publike>;

14) të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 1.1.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 26.05.2023, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 29.05.2023 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Proedurave Administrative;
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr.9590, datë 27.07.2006 Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe Komiteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”;
- Vendim i KPP-së nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimim në një procedure prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar;
- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit. Të ketë njohuri mjaft të mira të

paketës Microsoft Office; Të njohë gjuhën angleze të mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të huaja në Universityetin e Tiranës ose me provime kombëtare/ndërkombëtare të njohura sipas akteve ligjore në fuqi. Njohja e një gjuhe tjetër të huaj përbën avantazh.

- Të ketë aftësi komunikuese;
- Të ketë aftësi në koordinim, organizim dhe planifikim;
- Të ketë dëshirë dhe aftësi për të bashkëpunuar në grup
 - Njohuri mbi procesin e integritit europian

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti Ad-hoc i Pranimit për Levizje Paralele, i ngritur në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- **Kandidatët do të vlerësohen për përvojën**, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.
- **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Komisionit të Prokurimit Publik do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2-PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e KPP-së, pas datës 26.05.2023

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për procedurën e pranimi në shërbimit civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçantasi vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master i Shkencave në Shkenca Juridike/Ekonomike/Shoqërore. Diploma Bachelor të jetë e së njëjtës fushë.

Përvoja:

Të ketë 1 (një) vite eksperiencë pune në profesion.

Tjetër:

- d- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- e- aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi; aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- f- njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta;>
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;
- 3) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 5) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 6) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 7) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 8) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 9) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 10) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;
- 11) formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas lidhjes <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-ivetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-oseushtrojne-funksione-publike;>

12) të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 2.2.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 31.05.2023, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **02.06.2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit”
- Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr.9590, datë 27.07.2006 Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe Komiteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”;
- Vendim i KPP-së nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimim në një procedure prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar;

- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit. Të ketë njohuri mjaft të mira të paketës Microsoft Office; Të njohë gjuhën angleze të mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të huaja në Universitytin e Tiranës ose me provime kombëtare/ndërkombëtare të njohura sipas akteve ligjore në fuqi. Njohja e një gjuhe tjetër të huaj përbën avantazh.
- Të ketë aftësi komunikuese;
- Të ketë aftësi në koordinim, organizim dhe planifikim;
- Të ketë dëshirë dhe aftësi për të bashkëpunuar në grup
 - Njohuri mbi procesin e integritetit europian

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimit Ad-hoc për Ngritjen në Detyrë në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë kandidatët në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, si dhe në stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia Përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetkatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në (KPND) për rezultatin e pikëve brenda 3 (tri) ditëve

kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.7

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të internetit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Adresa: Komisioni i Prokurimit Publik, Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati I”, Tiranë

Njësia Përgjegjëse